

AKT THEMELIMI

SHOQËRISË “GJONAJ GROUP HOLDINGS” SHPK

Në Tiranë, sot më 19.07.2022, **Marin Gjonaj**, i biri i Besnikut, shtetas shqiptar, lindur në Tiranë, më 30.08.1985 dhe banues në Tiranë, madhor e me zotësi të plotë për të vepruar, me vullnetin e tij të plotë të lirë e të pacenuar, vendos të themelojë shoqërinë “**GJONAJ GROUP HOLDINGS**” SHPK në cilësinë e ortakut të vetëm themelues të saj.

Bazuar në nenet 6 e vijues të ligjit nr.9901, datë 14.04.2008 “Për tregtarët dhe shoqëritë tregtare” (i ndryshuar), nënshkruhet ky Akt Themeli, në të cilin Ortaku i Vetëm Themelues shpreh vullnetin të themelojë shoqërinë tregtare “**GJONAJ GROUP HOLDINGS**” SHPK, me kushtet si vijon:

NENI 1

Emri i shoqërisë

- 1.1. Emri i shoqërisë do të jetë “**GJONAJ GROUP HOLDINGS**” SHPK.
- 1.2. Ortaku i vetëm themelues i shoqërisë gjëzon përgjegjësi të kufizuara deri në pjesën e pashlyer të kontributive të nënshkruara.

NENI 2

Forma e shoqërisë

- 2.1. Forma e shoqërisë “**GJONAJ GROUP HOLDINGS**” SHPK (në vazhdim referuar si “Shoqëria”) do të jetë shoqëri me përgjegjësi të kufizuar, sipas parashikimeve të ligjit nr.9901, datë 14.04.2008 “Për tregtarët dhe shoqëritë tregtare” (i ndryshuar), derisa të vendoset ndryshe për shndërrimin në një formë tjeter ligjore të parashikuar nga legjislacioni për shoqëritë tregtare.
- 2.2. Shoqëria është person juridik privat shqiptar dhe gjëzon personalitet juridik nga data e regjistrimit të saj.

NENI 3

Selia e shoqërisë

- 3.1. Selia e shoqërisë ndodhet në Tiranë, Shqipëri, në adresën: Ndërtesa “Park Gate”, rruga e Elbasanit, katë i parë.
- 3.2. Shoqëria ka të drejtë të ndryshojë selinë e saj në një adresë dhe/ose qytet tjeter brenda Republikës së Shqipërisë, si dhe ka të drejtë të hapë degë ose zyra përfaqësimi të saj kudo brenda ose jashtë territorit të Republikës së Shqipërisë.

NENI 4

Kohëzgjatja e Shoqërisë

- 4.1. Afati kohor i zhvillimit të aktivitetit është i pakufizuar dhe fillon me regjistrimin e Shoqërisë në Qendrën Kombëtare të Biznesit.
- 4.2. Ortaku i Vetëm i Shoqërisë mund të vendosë kufizimin e afatit të veprimtarisë dhe më pas zgjatjen e tij një apo disa herë, sipas një vendimi të posaçëm.

NENI 5

Objekti i veprimtarisë

- 5.1. Objekti i Veprimtarisë së Shoqërisë do të jetë, por duke mos u kufizuar në të:
 - *"Investime në instrumente financiare, të cilat përfshijnë pa kufizim titujt e pjesëmarrjes në kapitalin e shoqërive tregtare (kuotat dhe aksionet), titujt e borxhit, aksionet ose kuotat ne fonde investimesh, obligacione private ose publike ndërkomëtare etj.,*
 - *Themelimin dhe zotërimin e shoqërive tregtare, pjesërisht ose tërësisht;*
 - *Investime në pasuri të luajtshme dhe të paluajtshme,*
 - *Ofrimi i shërbimeve të konsulencës për shoqëritë e kontrolluara prej saj, tërësisht ose pjesërisht, dhe/ose të tretë në përputhje me legjislacionin e zbatueshëm në territorin e Republikës së Shqipërisë dhe jashtë saj, duke përfshirë por pa u kufizuar në konsulencën e natyrës financiare, menaxheriale, ligjore, IT, zhvillim software-sh etj.*
 - *Gjithashtu, shoqëria mund të kryejë çdo veprim, operacion apo transaksion tjetër tregtar, industrial e financiar, të dobishëm apo plotësues ndaj përbushjes së objektit të shoqërisë, me kusht që aktivitetet e mësipërme të mos janë në kundërshtim dhe të mos ndryshojnë objektin parësor të veprimtarisë së shoqërisë."*

- 5.2. Shoqëria ka të drejtë të shtojë, pakësojë apo ndryshojë objektin e veprimtarisë së saj, në përputhje me parashikimet e legjislacionit në fuqi.

NENI 6

Kapitali i Shoqërisë

- 6.1. Kapitali bazë i shoqërisë është në vlerën ALL 99,220,506.40 (nëntëdhjetë e nëntë milionë e dyqind e njëzet mijë e pesëqind e gjashtë lekë e dyzet qindarka), i përbërë nga 1 (një) kuotë, me vlerë nominale ALL 99,220,506.40, e cila i jep ortakut të vetëm të drejtën e pjesëmarrjes prej 100% në kapitalin bazë të shoqërisë.
- 6.2. Ortaku i vetëm themelues zotëron kuotën e vetme të shoqërisë përcaktuar në nenin 6.1 më sipër.
- 6.3. Ortaku i vetëm themelues ka detyrimin të shlyejë kapitalin bazë të shoqërisë në tërësinë e tij brenda 6 (gjashtë) muajve nga data e regjistrimit të shoqërisë.

NENI 7

Organet Drejtuese

- 7.1. Bazuar në dispozitat e ligjit nr.9901, datë 14.04.2008 "Për tregtarët dhe shoqëritë tregtare" (i ndryshuar), organet drejtuese të shoqërisë janë:
1. **Asambleja e Përgjithshme e Ortakëve/Mbledhja e Ortakut të Vetëm**, e cila është organi më i lartë vendimmarrës;
 2. **Administratori**, i cili është organi ekzekutiv dhe administrativ i Shoqërisë.

- 7.2. Mënyra e organizimit dhe funksionimit të tyre është e përcaktuar në Statutin e Shoqërisë.

NENI 8

Administrimi

- 8.1. Shoqëria do të administrohet nga Administratori/Administratorët i/e saj, i cili/të cilët mund të zgjidhet/zgjidhen për një afat deri në pesë vjet me të drejtë rizgjedhjeje.
- 8.2. Administratorja aktuale e shoqërisë "GJONAJ GROUP HOLDINGS" SHPK do të jetë **Znj.Kristjana Zhamo**, e bija e Bardhyl-it, lindur në Përmjet, më 10.05.1993 e banuese në Tiranë, identifikuar nëpërmjet letërnjoftimit me nr.033450465 dhe nr.personal J35510032J, madhore e me zotësi të plotë për të vepruar.
- 8.3. Administratorja emërohet për një afat 5 (pese) vjeçar, me të drejtë riemërimi, duke nisur ky afat nga data e regjistrimit të saj pranë Qendrës Kombëtare të Biznesit.
- 8.4. Shoqëria do të përfaqësohet përpara çdo organi administrativ, gjyqësor, apo çdo entiteti tjetër publik apo privat dhe në marrëdhënie me të tretët nga Administratorja e shoqërisë (apo nga një ose disa persona të autorizuar prej saj), e cila i ushtron të drejtat dhe detyrimet e saj në përputhje me Statutin e shoqërisë dhe me legjislacionin shqiptar në fuqi.

NENI 9

Ligji i aplikueshëm

- 9.1. Veprimtaria e Shoqërisë rregullohet nga legjislacioni në fuqi në Republikën e Shqipërisë, ky Akt Themelimi, si dhe parashikimet e Statutit të saj.

NENI 10

Regjistrimi

- 10.1. Shoqëria do të regjistrohet pranë Qendrës Kombëtare të Biznesit nga administratorja dhe/ose një/disa person(a) të autorizuar prej saj për këtë qëllim, në përputhje me legjislacionin në fuqi.

NENI 11

Dispozitat përfundimtare

- 11.1 Ky Akt Themelimi hartohej në 3 (tre) kopje në gjuhen shqipe dhe nënshkruhet nga ortaku i vetëm themelues i saj.

ORTAKU I VETËM THEMELUES

SHOQËRISË “GJONAJ GROUPS HOLDINGS” SHPK

Marin GJONAJ